



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 5814 Prot.

Lezhë, më 05 / 05 /2026

VENDIM

Nr. 43, Datë 30. 04. 2026

**PËR MIRATIMIN E ZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË KRYESIVE DHE TË KRYETARËVE
TË TRE FSHATRAVE NË BASHKINË LEZHË**

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; neni 8, neni 53, neni 54 dhe neni 70, si dhe në Rregulloren e Këshillit të Bashkisë Lezhë e miratuar me Vendimin Nr. 54, datë 28.04.2020 të Këshillit Bashkiak, i ndryshuar, Vendimit Nr 8, datë 28.01.2026 “Për zgjedhjen e Anëtarëve të Kryesisë dhe të Kryetarëve të Fshatrave në fshatrat ku kryetarët janë të emëruar nga Kryetari i Bashkisë”, Vendimit Nr 24, datë 25.02.2026 “Për përcaktimin e datave të reja për zgjedhjen e anëtarëve të kryesisë dhe të kryetarëve të fshatrave në fshatrat Tresh, Kodër Mulliri dhe Krajën”, Rregullores së Strukturave Komunitare e miratuar me Vendimin Nr. 29, datë 30.08.2023 të Këshillit Bashkiak, pas njohjes së materialit zgjedhor për çdo lagje e fshat nga grupet e punës, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

Vendosi :

1. Të miratojë zgjedhjet e anëtarëve të Kryesive dhe Kryetarëve të Fshatrave sipas dokumentacionit zgjedhor të paraqitur nga komisionet e monitorimit për fshatrat:

- ❖ Fshati Kodër Mulliri: **Kryetar Fshati** Petrit Suli
Anëtarë të Kryesisë Petrit Suli, Paulin Miraj, Fatjon Peraj
- ❖ Fshati Rrilë: **Kryetar Fshati** Arben Paluca
Anëtarë të Kryesisë Arben Paluca, Pal Gjetaj, Artur Kola, Albert Rusti, Prend Perkola
- ❖ Fshati Tresh: **Kryetar Fshati** Preng Markolaj
❖ **Anëtarë të Kryesisë** Preng Markolaj, Fran Marku, Andi Marku, Andrea Gjini

2. Në fshatrat që ka dështuar zhvillimi i mbledhjeve në datat e përcaktuara në VKB Nr 8, datë 28.01.2026 dhe në VKB Nr. 24, datë 25.02.2026, në bazë të nenit 70, pika 4, paragrafi i dytë të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, kompetenca për emërimin e kryetarëve në fshatrat që nuk janë realizuar zgjedhjet i kalon Kryetarit të Bashkisë Lezhë dhe konkretisht:

• **Njësia Administrative Balldre**

- ❖ Fshati Balldre Fushë
- ❖ Fshati Gocaj
- ❖ Fshati Qender Kakarriq

- ❖ Fshati Mal Kakarriq
 - Njësia Administrative Blinisht
 - ❖ Fshati Krajen
 - Njësia Administrative Dajç
 - ❖ Fshati Dajç
 - ❖ Fshati Dragushë
 - ❖ Fshati Kotërr
 - ❖ Fshati Mabë
 - Njësia Administrative Kallmet
 - ❖ Fshati Mërqi
 - Njësia Administrative Kolsh
 - ❖ Fshati Kolsh
 - ❖ Fshati Kaçinar
 - Njësia Administrative Shënkoll
 - ❖ Fshati Grykë Lumi
 - Njësia Administrative Ungrej
 - ❖ Fshati Fregen
 - ❖ Fshati Rras i Butë
 - ❖ Fshati Kalivaç
3. Brenda datës 15.05.2026 Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa për mbledhjen e vulave nga Kryetarët aktualë të çdo fshati, Të marrë masa që vulat dhe dorëzimi i bazës materiale dhe dokumentare nga Kryetarët aktualë tek Kryetarët e zgjedhur dhe ata të emëruar nga Kryetari i Bashkisë sipas përcaktimeve në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi të realizohet brenda datës 01.06.2026.
 4. Shpërblimi mujor për kryetarët e zgjedhur dhe të emëruar nga Kryetari i Bashkisë, sipas përcaktimeve në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, të fillojë nga muaji Maj 2026.
 5. Ky vendim i behet i njohur nga Kryetari i Këshillit të Bashkisë gjithë institucioneve shtetërore që merren me trajtimin e pronave dhe shërbimeve ndaj qytetarëve në Qarkun Lezhë si dhe organeve të rendit.
 6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55 të ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar..

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ



KRYETARI
NDUE LULI

